



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



12 Nr 400-22842 dt. 29.06 2020

Bazuar në nenin 11,12 dhe 40, të Ligjit për Vetëqeverisjes Lokale nr.03/L-040, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullores 12 nr.320-19332 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, rregullores MF-NR 04/2017, Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, vendimit me nr.12.nr.400-37743 të datës 03.07.2018 Për plotësim ndryshimin e Rregullores nr.12-320-19338, për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, si dhe Buxheti i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit për vitin 2020. Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me date **29.06.2020**, miratoi këtë:

V E N D N I M
PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT KVRL DRENAS

Neni 1.

Me këtë propozim vendim, kërkohet mbështetja financiare për projektin e Këshillit të Veprimit Rinor Lokal (KVRL) – Drenas, lidhur me mbulimin e shpenzimeve për zhvillimin e aktiviteteve për vitin 2020.

Neni 2.

Projekti i Këshillit të Veprimit Rinor Lokal (KVRL) – Drenas, përkrahet me shumën prej **3,000.00€ (tre mijë euro)**, mjete të cilat do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve për vitin 2020.

Neni 3.

Financimi-Subvencionimi i projektit do të bëhet nga Buxheti i DRKS-së nga kategoria ekonomike e shpenzimeve, subvencioneve dhe transfereve, kodi ekonomik 21/611/85001/200/0000/0820

Neni 4.

Mjetet financiare barten në konton e Këshillit të Veprimit Rinor Lokal (KVRL)-Drenas. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport është e obliguar që për shumën e mjeteve për financimin e përmendur në nenin 2 të këtij propozim vendimi të përcjellë implementimin e projektit, duke

kërkuar nga Këshilli i Veprimit Rinor Lokal (KVRL) – Drenas, që të bëj raport tekstual dhe financiar në mënyrë që të njoftoj DKRS-në për mënyrën e shpenzimeve të mjeteve financiare.

Neni 5.

Për monitorimin dhe zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës së Drenasit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi pas miratimit nga Kuvendi Komunal i Drenasit si dhe nënshkrimi nga ana e kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labmir Halilaj